

VENDIM
Nr. 689, datë 6.12.2023

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1134, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË TIRANË DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nëndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 1134, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, në masën 176 394 915 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e treqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore (RSU nr. 1 (nr. 15–18–19) nr. 20–21; nr. 22–23", në RSU nr. 1, shkolla "Dritas", në Bashkinë Tiranë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar, përkatësisht, sipas detajimit të mëposhtëm, për:

a) ndërtimin e godinës tip në RSU nr. 1 (nr. 15), në vlerën 143 361 593 (njëqind e dyzet e tre milionë e treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH;

b) ndërtimin e godinës tip në RSU nr. 1 (nr. 19), në vlerën 10 544 343 (dhjetë milionë e pesëqind e dyzet e katër mijë e treqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH;

c) rikonstruksionin e godinave nr. 20–21, nr. 22–23, në vlerën 22 488 979 (njëzet e dy milionë e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku